



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR



DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE  
LEZHË  
ZYRA ARSIMORE VENDORE  
SHKODËR

Nr. 18282 Prot  
Shkodër, më 25.10.2019

Nr. 1108 Prot  
Shkodër, më 30.10.2019

### MARRËVESHJE

### PËR PËRDORIMIN E PALESTRAVE TË SHKOLLAVE NË FUNKSION TË SPORT KLUB VLLAZNIA

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër me datë 30/10/2019 ndërmjet palëve si më poshtë vijon:


**Bashkia Shkodër**, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**.

*Dhe*

**Zyra Arsimore Vendore Shkodër** me adresë: Sheshi Isa Buletini, Rruga Edith Durham, përfaqësuar nga Përgjegjës i Zyrës Arsimore Vendore **Znj. Elira Smakaj**, këtej e tutje i cilesuar si Zyra Arsimore Vendore Shkodër (**ZVA Shkoder**) .

#### Baza Ligjore:

- Ligji nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji 8744 date 22.02.2001“ Per transferimin e pronave te paluajtshme publike ne njesite e qeverisjes vendore” të ndryshuar.
- Ligj 79/2017 “Për sportin”
- Ligji 69/2012, date 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- VKM 421 date 02.06.2010 “Per miratimin e Listes se inventarit te pronave te paluajtshme shtetore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim Bashkise Shkoder“ i ndryshuar
- VKB nr 51 date 29.09.2014 “Per miratimin e hapjes se procedurave per dhenien ne perdorim te palestrave te shkollave per stervitjen e ekipeve zinxhir te Sport KlubVllaznia”.



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



- VKB nr. 82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar.

-Urdhër i Ministrisë Arsimit dhe Shkencës n.343, datë 19.08.2018 “Për miratimin e dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar”.

-Urdheri nr 430 , date 31,10,2014 “ Per organizimin e sportit ne institucionet arsimore te sistemit parauniversitar”

-Marreveshja e mirekuptimit dhe e bashkepunimit mes Ministrise se Arsimit dhe Sportit dhe Federates Shqiptare te Hendbollit nr. Prot. 4073, date 18/04/2016

## NENI 1

### Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje është përcaktimi i mënyrës së përdorimit, mirëmbajtjes, rregullat dhe afatet e përdorimit të palestrave të shkollave të përcaktuara në këtë marrëveshje për tu përdorur në realizimin e stervitjes së ekipeve të moshave të Sport Klub Vllaznia.

## NENI 2

### Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale mes Bashkisë Shkodër dhe Zyrës Arsimore Vendore për përdorimin e palestrave të shkollave të përcaktuara në këtë marrëveshje në shërbim të stervitjes së ekipeve të moshave të Sport Klub Vllaznia sipas një orari stervitjesh te mirëpërcaktuar.

## Neni 3

### Kohëzgjatja e marrëveshjes


Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje do të jetë nga data e nënshkrimit saj deri më 31.09.2020.

## NENI 4


### Rolet dhe përgjegjësitë e palëve

#### Bashkia Shkodër

- Bashkia Shkoder merr përsiper mirëpërdorimin dhe mirëmbajtjen e palestrave të përcaktuara gjatë gjithëperiudhes së stervitjes si aset i saj.
- Përcakton personin përgjegjes për secilen shkolle i cili do te përgjigjet për të gjitha çështjet që mund të ngrihen dhe që kerkojne zgjidhje. Ky person përgjegjës është i



Adresa: Nr. 13 Diktatori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



përcaktuar në këtë marrëveshje për secilen shkolle dhe bashkëpunon ngusht me drejtorin e shkolles për mbarëvajtjen e kësaj marreveshjeje dhe zbatimin e orarit të stervitjes.

- Përcakton personin përgjegjës për pastrimin e palestrave pas stervitjes ne menyre qe ato te jene te gatshme per fillim normal te procesit mesimor ditën pasardhese.
- Merr përsiper pagesën e shtesës së harxhimit të energjisë elektrike të harxhuar në shkollë gjatë periudhes stervitore.
- Merr persiper mirëmbajtjen e infrastruktures dhe të bazës materiale të shkolles dhe të palestrave gjatë kohes që zhvillohet stervitja në keto palestra.
- Merr përsiper në raste dëmtimesh të ardhura si pasojë e stervitjes, të riparoje dëmin e shkaktuar.
- Merr persiper shtesë fondesh sipas planeve të paraqitura nga vetë shkollat për mirëmbajtjen dhe përmiresimin e kushteve të këtyre palestrave.
- Paraqet listat e përditesuara të ekipeve zinxhir të federuara pranë federatave respektive të Sport Klub Vllaznia së bashku me trajnerin përkates ne ZVA Shkodër.
- Merr persipër që në bashkëpunim me ZVA Shkodër që të modifikojë oraret e stervitjeve të ekipeve të Sport Klub Vllaznia në rastet kur shkollat kanë aktivitete të ndryshme të parashikuara me ekipet sportive respektive shkollore.


#### **Zyra Arsimore Vendore Shkodër (ZVA Shkoder)**

- Zyra Arsimore Vendore Shkodër lejon përdorimin e palestrave të shkollave të përcaktuara në këtë marrëveshje në shërbim të stervitjes së ekipeve zinxhir të SportKlub Vllaznia pas orarit mësimor.
- Përcakton drejtorin e shkolles si personin përgjegjës për mbarëvajtjen e kësaj marrëveshjeje. Ky person duhet te bashkëpunoje ngusht me personin përgjegjës të përcaktuar nga Bashkia Shkoder për ti dhënë zgjidhje çështjeve të dala gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
- Kur është e nevojshme për përdorim të palestrave për stervitje ekstra kurrikulare ose aktivitete të ndryshme sportive mes ekipeve sportive të shkollës, ZVA Shkoder paraqet ne Drejtorine e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit skedulen e stervitjes së shoqatës sportive të shkolles në mënyrë që të modifikohen oraret e stervitjes së ekipeve të SK Vllaznia duke i krijuar hapësire aktivitetit të mesiperm.


#### **Neni 5**

#### **Palestrat e Shkollave/Personat përgjegjës dhe oraret e stervitjes**

Ditët e stervitjes së ekipeve te SportKlub Vllaznia do të jenë nga e hëna në të premte të çdo jave, sipas orareve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:



Adresa: 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)




Nr	Shkolla	Drejtuesi i Shkolles (ZVA Shkoder)	Pergjegjesi Bashkia Shkoder	Ekipi & Orari
1	Edith Durham	Mimoza Livadhi	Izmir Kashi	Gjimmastike (16 <sup>00</sup> -19 <sup>00</sup> )
2	Azem Hajdari	Arjana Haxhaja	Elton Deniku Fatjon Çekini	Volejboll (14 <sup>00</sup> -18 <sup>00</sup> )
3	Xheladin Fishta	Zef Dalldyshja	Fatjon Hallunaj Xhuljeta Shestani	Basket (14 <sup>30</sup> -20 <sup>30</sup> )
4	Shejnaze Juka	Kole Shiroka	Ermal Milla Klavia Peteza Ferdinand Bardeli	Volejboll/Basketboll (14. <sup>00</sup> -20 <sup>00</sup> )
5	Salo Halili	Gazmir Jahiqi	Fatjon Serhati Albert Marashi Bruno Rrotani Dorian Tafa	Atletike (14 <sup>00</sup> -18 <sup>00</sup> )
6	Branko Kadija	Surila Mlloja	Artan Durro Ardit Qiellza	Hendboll (18 <sup>30</sup> -20 <sup>00</sup> )
7	28 Nentori	Albana Bushati	Ervin Berdica	Basketboll (15 <sup>00</sup> - 18 <sup>00</sup> )

**NENI 6**  
**Dispozita të fundit**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje e barazvlefshme.

Në rast ndryshimi të emrave të përveçëm të shkollave si dhe personave përgjegjës të përcaktuar në këtë marrëveshje do të ketë komunikim ndër institucional mes palëve.




Çdo ndryshim apo modifikim në termat e kësaj marrëveshjeje, do të negociohet mes palëve dhe do finalizohet me Anekse të kësaj marrëveshjeje, nënshkruar nga të dy palët

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Palët pasi e lexuan marrëveshjen, me vullnetin e tyre të lire e nënshkruan atë.

**PËR  
BASHKINË SHKODËR**

**KRYETAR**



**Vulliam Ademi**

**PËR  
ZYRËN ARSIMORE VENDORE  
SHKODËR**

**DREJTOR**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Elira Smakaj", written over a circular official stamp.

**Elira Smakaj**

